



## **Analizë e Projektligjit**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

# PROJEKTLIGJI PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORT

Autor: Visar Ramaj

---

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

## **I. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE E ANALIZËS LIGJORE TË PROJEKTLIGJIT PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORT**

Projektligji 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe (tutje referuar si Projektligji për masat mbrojtëse në import) rregullon procedurat për marrjen e masave mbrojtëse në rastet kur një produkt importohet në Republikën e Kosovës në sasi të rritur sa që shkakton dëm apo kërcënim për dëm serioz të prodhuesve vendor që prodhojnë mallrat e ngjashme ose identike dhe që janë drejtpërdrejte konkurruese.

Bazë për rregullimin e ri ligjor Për Masat Mbrojtëse në Import paraqet Rregullorja e BE-së për Rregulla të Përbashkëta të Importit e cila është e bazuar në Marrëveshjen për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë (Tutje referuar si “OBT”), ku Aneksi 1A i së cilës përmban Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (Tutje referuar si “GATT 1994”) dhe Marrëveshjen për Masat Mbrojtëse.

Analiza e Projekt Ligjit për Masat Mbrojtëse në import është bërë në përputhje të plotë me Standardet Ligjore të Rregullores së BE-së për Rregulla të Përbashkëta të Importit dhe të rregullativës ligjore të OBT-së mbi definimin e llojeve të masave mbrojtëse në import të cilat lejohen të aplikohen në Kosovë, procedurat për fillimin apo refuzimin e hetimit për vendosjen e masave mbrojtëse, si dhe vendimet për aplikimin e masave mbrojtëse.

Analiza e rekomandon për aprovim Projekt-ligjin për Masat Mbrojtëse në Import sipas komenteve për ndryshime dhe plotësime të përfshira në këtë analizë. Më saktësisht, kjo analizë kërkon adresimin e tri çështjeve kryesore në draftin aktual të projekt-ligjit, dhe atë a) Projekt ligji duhet të ndryshojë përcaktimin e llojeve të masave mbrojtëse dhe duhet të definojë parimet të përgjithshme për aplikimin e masave mbrojtëse, b) Projekt ligji duhet të qartësojë rolin dhe kompetencat e ministrisë, qeverisë dhe të komisionit për vendosjen e masave mbrojtëse dhe c) Projekt-ligji duhet të ulë kërkesat për pranueshmërinë e kërkesave për inicimin e hetimit.

## II. STRUKTURA E IMPORTEVE DHE EKSPORTEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE NDËRLIDHJA ME PROJEKT-LIGJIN PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORTE

Projekt-ligji për Masat Mbrojtëse në Importe paraqet rregullativë me rëndësi ligjore për mbrojtjen e industrisë vendore nga importet e rritura në mënyrë të papritur dhe në masë të konsiderueshme. Si e tillë, është e ndërlidhur në mënyrë organike me raportet tregtare të Kosovës.

Në këtë analizë përfshin një vështrim të përgjithshëm të sektorit të tregtisë së jashtme të Republikës së Kosovës, statistikat e përgjithshme tregtare të importit dhe eksportit, si dhe strukturën e mallrave që eksporton dhe importon Kosova. Po ashtu në këtë analizë paraqitet një pasqyrë e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me partnerët tregtar të ndarë në tri grupe: BE, vendet fqinje - si pjesë e CEFTA-s, dhe pjesa tjetër e botës.

### A. Tregtia e Jashtme

Kosova krahasohet me deficit të lartë tregtar, i cili deficit është në rritje të vazhdueshme. Kjo paraqet indikator të varësisë së Kosovës nga importet dhe të mungesës së zhvillimit të industrisë vendase për të qenë konkurruese. Si shembull ilustrues, deficitin tregtar për muajin Dhjetor 2017 ka qenë në vlerë prej 267.8 milion euro, krahasuar me deficitin për muajin Dhjetor të vitit 2016 në vlerë prej 246.9 milion euro<sup>1</sup>, e cili paraqet rritje të deficitit në vlerë prej 8.5%.

#### i. EKSPORTI DHE IMPORTI

Importi i mallrave arrin vlerën 297.3 milion në dhjetor 2017, apo një rritje prej 9.5% duke krahasuar me periudhën e njëjtte të vitit të kaluar.

Ndërsa eksporti i mallrave në këtë periudhë arriti vlerën prej 29.4 milion euro, apo një rritje prej 20.2% krahasuar me periudhën e njëjtte të vitit 2016.

Në rritjen e importit kontribuojnë produktet minerale me një pjesëmarrje prej (15.3%), makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike me një pjesëmarrje prej (14.2%), ushqimet e përgatitura, pije dhe duhani (13.3%), mjetet e transportit (13.0%), metalet bazë dhe artikujt prej tyre me një pjesëmarrje prej (8.7%), produktet e industrisë kimike (6.4%), plastikë, gomë dhe artikujt prej tyre (4.8%), produkte bimore (4.7%), tekstil dhe artikujt prej tekstili (4.0%), etj.

Përqindja më e madhe e rritjes së eksportit përbëhet nga metalet bazë dhe artikujt prej tyre me një pjesëmarrje prej (42.8%), pastaj zënë vend me një përqindje të vogël produktet tjera si: (12.3%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (9.4%) plastikë, gomë dhe artikujt të tyre, (9.0%) produktet minerale, (5.9%) produktet bimore, (4.7%) tekstil dhe artikujt prej tekstili, etj.

---

<sup>1</sup> Agjencioni i statistikave të Kosovës, “Statistikat e tregëtisë së jashtme dhjetorë 2017, janar 2018.

Bilanci tregtar i Kosovës mbetet edhe më tutje negativ, ku shumë importojmë nga vendet tjera dhe më pak eksportojmë.

## ii. TREGTIA ME VENDET E BE-SË

Kosova, në aspektin e tregtisë së jashtme si partnere më të rëndësishme tregtarë gjatë viteve të fundit i ka vendet e BE-së si në importe asht edhe në eksporte. Nga kjo, 46.3% e importeve të përgjithshme të vendit apo 137.6 milion euro. Gjithashtu eksportet e destinuar në vendet e BE-së përfshijnë rreth 23.% të eksportit të përgjithshëm apo vlerën prej 6.8 milion euro<sup>2</sup>.

**Tabela 1:** Partnerët kryesor për importe dhe eksporte nga vendet e BE-së

Vendet	% e importeve	% e eksporteve
Gjermania	14.6%	6.2%
Italia	5.7%	-
Rumania	3.0%	-
Greqia	2.8%	-
Holanda	-	3.9%
Britania e Madhe	-	3.6%
Bullgaria	-	2.7%

Burim: (ASK)2018

## iii. TREGTIA ME VENDET E CEFTA-SË

Kosova është gjithashtu pjesë e Marrëveshjes Rajonale të Tregtisë së lirë CEFTA, në përbërje të shtatë (7) vendeve. Sa i përket Kosovës, mallrat e importuar nga vendet e CEFTA-së përfshijnë 26.8 % të importeve të përgjithshme apo 79.6 milion euro<sup>3</sup>. Partnerët kryesor tregtar të Kosovës në kuadër të CEFTA janë Serbia dhe Maqedonia.

<sup>2</sup>Agjencioni Kosovar i Statistikave, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, të qasshme në <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/tregtia-e-jashtme>

<sup>3</sup>Ibid.

**Tabela 2.** Partnerët kryesor për importe dhe eksporte nga vendet e CEFTA-Së

Vendet	% e importeve	% e eksporteve
Serbia	15.7%	5.5%
Maqedonia	4.2%	9.6%
Shqipëria	3.7%	17.7%
Bosnja Hercegovina	2.7%	-
Mali i Zi	-	3.2%

Burimi: (ASK) 2018<sup>4</sup>

Përkundër disbalancit të madh tregtar të Kosovës me vendet anëtare të CEFTA, eksportet në vendet e CEFTA-s vazhdojnë të luajnë rol me rëndësi për ekonomike e Kosovës. Në këtë mënyrë, gjatë periudhës Dhjetor 2017 eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së përfshinë 40.5% të eksporteve të përgjithshme, apo shprehur në vlerë monetare prej 11.9 milion euro.

#### iv. TREGTIA ME VENDET E TJERA TË BOTËS

Përfundimisht, shkëmbimet tregtare me vendet jashtë BE-së dhe jashtë zonës CEFTA kanë gjithashtu një rëndësi të madhe të Kosovës, edhe pse edhe në këtë drejtim ka një disbalanc të madhe tregtare edhe me këto vende. Mallrat e importuara në Kosovë nga vendet tjera arrijnë në vlerë prej 79.9 milion euro apo 26.9% të importit të përgjithshëm<sup>5</sup>. Eksportet me vendet e tjera të botës përfshijnë 10.6 milion euro të eksportit të përgjithshëm apo 36.2% të vlerës së eksporteve të përgjithshme. .

**Tabela 3.** Partnerët kryesor të importit me vendet tjera të botës

Vendet	% e importeve	% e eksporteve
Kina	9.6%	
Turqia	8.5%	
India	-	24.4%
Zvicra	-	5.2%

<sup>4</sup>Ibid.

<sup>5</sup>Ibid.

v. EKSPORTI DHE IMPORTI SIPAS SEKSIONEVE TË KLASIFIKIMIT  
STANDART TË TREGËTISË SË JASHTME

Sa i përket strukturës së importeve dhe të eksporteve, gjatë vitit 2016 dhe 2017 ka ndryshime shumë të vogla, që është tregues i natyrës reale të strukturës ekonomike. Në këtë mënyrë, importet kryesisht janë të koncentruar me makineri e pajisje transporti, të cilat kanë pjesëmarrje me një përqindje prej 26.9%, pasuar nga ushqimet dhe kafshët të gjalla me një pjesëmarrje prej me 17.1% në. Në anën tjetër, struktura e eksporteve dominohet nga mallrat e përpunuara, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 41.6%, të ndjekura nga materiale të papërpunuara me një pjesëmarrje prej 20.5%<sup>6</sup>.

**Tabela 4.** Eksportet dhe importet sipas seksioneve të KSTJ (SITC)

Struktura e eksporteve	Dhjetor 2017	Dhjetor 2016
Makineri dhe Pajisje Transporti	26.9%	25.6%
Ushqime dhe kafshë të gjalla	17.1%	17.4%
Mallra të përpunuar	16.7%	16.7%
Lëndë djegëse	14.4%	12.5%

Struktura e importeve	Dhjetor 2017	Dhjetor 2016
Mallra të Përpunuara	41.6%	31.5%
Materiale të papërpunuara	20.5%	27.1%
Ushqime dhe kafshë të gjalla	9.4%	11.1%

Burim: (ASK) 2018

---

<sup>6</sup>Ibid.

### **III. INSTRUMENTET JURIDIKE NDËRKOMBËTARE NË TË CILAT ËSHTË BAZUAR PROJEKT-LIGJI PËR MASAT MBROJTËSE PËR IMPORTE**

Projekt-ligji për Masat Mbrojtëse në Importe duhet të vlerësohet në përputhje me standardet ligjore të parashikuara me Rregulloren e BE-së për Rregullat e Përbashkëta për Import dhe me Marrëveshjen për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë.

Fillimisht, vlerësimi në përputhje me Rregulloren e BE-së për Rregullat e Përbashkëta për Import është obligim i cili rrjedhë nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) në mes të Kosovës dhe BE-së, dhe pjesë e obligimeve për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian. Në anën tjetër, vlerësimi sa i përket përputhshmërisë me Marrëveshjen për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, bëhet për arsye se edhe vetë BE-ja është pjesë e marrëveshjes së tillë dhe vetë Rregullorja e BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import duhet të jetë në përputhje të plotë me standardet e parashikuara në kuadër të marrëveshjeve të OBT-së.

Rrjedhimisht, kjo analizë e vlerëson dhe analizon Projekt-ligjin për Masa Mbrojtëse në import në Përputhje me këtë rregullative ligjore të BE-së dhe të OBT-së.

#### **A. Marrëveshja për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Marrëveshja Për Masat Mbrojtëse**

BE-ja është pjesë e Marrëveshjes për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë (Tutje referuar si “OBT”), ku Aneksi 1A i së cilës përmban Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (Tutje referuar si “GATT 1994”) dhe Marrëveshjen për Masat Mbrojtëse. Duke qenë se BE-ja është pjesë e GATT 1994, rrjedhimisht, edhe Rregullorja e BE-se për masat mbrojtëse në import rregullon dhe detajon procedurat dhe standardet për vendosjen e masave mbrojtëse në përputhje me obligimet e përgjithshme të cilat rrjedhin nga GATT 1994 dhe Marrëveshja për Masat Mbrojtëse.

Në kuadër të legjislacionit të OBT-së, masat mbrojtëse emergjente për qëllime të mbrojtjes së ekonomisë vendore, për të cilat arsye lejohen shmangje të aplikimit të parimeve të legjislacionit të OBT-së, mund të jenë të tri natyrave të veçanta: a) Masat Mbrojtëse sipas Marrëveshjes GATT 1994 dhe Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse, b) Masat Mbrojtëse sipas Marrëveshjeve të veçanta (Shembull: bujqësia) dhe c) Masat Mbrojtëse për shkak të bilancit të pagesave.

Projekt-ligji për Masat Mbrojtëse të Importit është pjesë dhe duhet të jetë në përputhje me pikën a të legjislacionit të OBT-së, e cila përfshinë Marrëveshjen GATT 1994 dhe Marrëveshjen për Masa Mbrojtëse në kuadër të GATT 1994.

Sipas këtyre standardeve të OBT-së, për aplikimin e masave mbrojtëse, duhet të vlerësohen: a) Kushtet të cilat duhet plotësuar për aplikimin e masave mbrojtëse, b) Procedurën e Brendshme të



aplikimit të masave dhe të njoftimit dhe konsultimit me vendin i cili preket në raport me aplikimin e masave mbrojtëse.

Fillimisht, GATT 1994 dhe Marrëveshja për Masat Mbrojtëse parashohin që duhet të plotësohet tri kushte në mënyrë kumulative për aplikimin e masave mbrojtëse. Kushti i parë, i parashikuar me Nenin 2.1. Të Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse, kërkon të dëshmohet rritje e importeve në mënyrë të paparashikuar. Në këtë drejtim, rritja e importeve mund të jetë si rritje absolute (rritje për njësi), apo rritje relative (rritje e importeve në krahasim me industrinë vendore)<sup>7</sup>.

Kushti i dytë i parashikuar me Nenin 4.1. Të Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse kërkon që të dëshmohet “dëmi serioz” për industrinë vendore, e cili përfshinë kërcënimin dhe dëmtimin e pozitës së industrisë vendore në treg. Në këtë drejtim, përfshihet edhe koncepti i “kërcënimin për dëmtim serioz”, i cili interpretohet si rast kur rrezikohet dëmtimi në rast të mos-marrjes së menjëhershme të masave mbrojtëse<sup>8</sup>.

Kushti i tretë i parashikuar i parashikuar me Nenin 4.2.b. Të marrëveshjes për Masa Mbrojtëse kërkon të dëshmohet kauzaliteti në mes të rritjes së importeve dhe dëmit apo kërcënimin për shkaktimin e dëmit të industrisë vendore, kjo bazuar në fakte dhe prova objektive<sup>9</sup>.

Në anën tjetër, pjesë substanciale e obligimit të shteteve në kuadër të aplikimit të Masave Mbrojtëse në import është edhe Rregullimi i procedurave të brendshme të ndërmarrjes së masave të tilla dhe të njoftimit të shteteve të prekura nga masat e tilla. Në këtë mënyrë, përmes nenit 3 të marrëveshjes për Masa Mbrojtëse, shtetet obligohen të udhëheqin një procedurë hetimore si parakusht i aplikimit të masave mbrojtëse, të sigurojnë qasje në prova dhe dokumente për palët e interesuar, dhe të nxjerrin vendime të arsyetuar të cilat demonstronjë plotësimin e tri kushteve të përshkruara më lartë.

Tutje, përmes Nenit 12, kërkohet nga shtete të njoftohet menjëherë OBT-ja dhe shtete anëtare të prekura nga masat mbrojtëse, kjo me qëllim të dhënies së mundësisë së shteteve të përfshira dhe të prekura nga masat mbrojtëse të konsultohen dhe të këmbejnë informacione në raport me rastin në hetim dhe aplikimin e masave mbrojtëse.

Përmes kësaj rregullative, OBT-ja vendos standarde minimale dhe parime udhëheqëse të procedurës për vendosje të masave mbrojtëse në importe. Këto standarde janë detajuar përmes Rregullores së BE-së për Rregullat e Përgjithshme për Import, të aplikueshme në BE, dhe gjithashtu legjislacioni i Kosovës duhet të inkorporojë këto parime në legjislacionin e tij.

---

<sup>7</sup> Marrëveshja për Masat Mbrojtëse GATT 1994, Neni 2.1.

<sup>8</sup> Ibid, neni 4.1.

<sup>9</sup> Ibid, Neni 4.2.b.

## **B. Rregullorja e BE-se për Rregullat e Përbashkëta për Import**

Në aplikim të GATT 1994 dhe të Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse, BE-ja ka nxjerrë Rregulloren e BE-së për Rregullat e Përbashkëta për Import, përmes të cilës rregullohet importi i produkteve nga vendet e treta dhe krijohet procedura Evropiane e Konsultimit dhe informimit<sup>10</sup>.

Rregullorja e BE për Rregulla të Përbashkëta për Import parashikon dhe rregullon në mënyrë të detajuar procedurat dhe kërkesat ligjore për aplikimin e masave mbrojtëse, parashikon nivel tejet të lartë të transparencën në raport me provat e mbledhura dhe të drejtën e palëve me interes të paraqesin argumentet dhe provat e tyre, afatet kohore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, dhe krijon një sistem të avancuar Evropian për informim dhe konsultim.

Si e tillë, Rregullorja e BE-së për Rregulla të Përbashkëta të Importit paraqet bazë të detajuar të implementimit të parimeve të parashikuara me GATT 1994 dhe Marrëveshjen për Masa Mbrojtëse.

---

<sup>10</sup> Rregullorja (BE) 2015/478 për Rregullat e Përbashkëta për Import, e qasshme në <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/76e02947-d458-11e4-9de8-01aa75ed71a1/language-en>

#### **IV. STANDARDI LIGJOR ËSHTË APLIKIMI I MASAVE MBROJTËSE NË MËNYRË TË KUFIZUAR DHE RASTE TË JASHTËZAKONSHME**

Aplikimi i masave mbrojtëse për importe paraqet masë të jashtëzakonshme të kufizimit të importeve dhe tregtisë së lirë me qëllim të mbrojtjes së tregut dhe ekonomisë vendore. Si e tillë, edhe në kuadër të praktikës ligjore të GATT-së 1994 dhe Marrëveshjes për Masat Mbrojtëse, dhe gjithashtu edhe në kuadër Rregullores së BE-së për Rregullat e Përbashkëta për Import, aplikimi i këtyre masave është shumë i kufizuar. Për më tepër, zbatimi i masave të tilla mbrojtëse është subjekt i vlerësimit strikt ligjor, nga ku edhe vlerësohet ligjshmëria e veprimeve të tilla.

Në anën tjetër, sqarimet e dhëna në Raportin për Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe<sup>11</sup>, dhe gjithashtu edhe sqarimet në Memorandumin Shpjegues për Projekt-ligjin për Masat Mbrojtëse në Importe, lënë të kuptohet se aplikimi i masave mbrojtëse synohet të aplikohet si masë e zakonshme për mbrojtjen e industrisë vendore. Një qasje e tillë është në kundërshtim me praktikën dhe legjislacionin ndërkombëtar të aplikueshëm, dhe mund të ketë përgjegjësi për Kosovën si zbatues i masave të tilla.

Në bazë të të dhënave zyrtare, që nga themelimi i OBT-së me 1995 deri më 2012 janë iniciuar 234 raste të procedurave për aplikimin e Masave Mbrojtëse, prej të cilave gjysma kanë rezultuar me aplikimin e ndonjë prej Masave Mbrojtëse<sup>12</sup>. Deri më sot, që nga themelimi i OBT-së janë lëshuar vetëm 118 Masa mbrojtëse të importeve në tërë vendet anëtare të OBT-së<sup>13</sup>.

Shtetet e Bashkuara të Amerikë paraqesin vendin e tretë për nga numri i rasteve të iniciuara, me dhjetë (10) raste të inicimit të procedurave të masave Mbrojtëse të Importeve, derisa në anën tjetër, Bashkimi Evropian ka iniciuar vetëm pesë (5) raste të Masave Mbrojtëse që nga themelimi i OBT-së<sup>14</sup>.

Rrjedhimisht, aplikimi i masave mbrojtëse të importeve paraqet masë të jashtëzakonshme dhe zgjidhje të fundit për mbrojtjen e industrisë vendore, dhe e cila është objekt i vlerësimit strikt të përgjegjshmërisë së shtetit. Andaj, Kosova duhet të ketë kujdes në aplikimin e masave të tilla, dhe ky ligj nuk duhet shikuar si mundësi për ndihmë për industrinë vendore.

---

<sup>11</sup> Raporti për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Prishtinë 2013

<sup>12</sup> Raportimet e Vendeve të OBT-së sipas procedurës së Nenit 12.1 të Marrëveshjes mbi Masat Mbrojtëse, raporti zyrtar i qasshëm në: [ëëë.ëto.org/english/tratop\\_e/safeg\\_e/SG-Initiations\\_By\\_Reporting\\_Member\\_.pdf](http://ëëë.ëto.org/english/tratop_e/safeg_e/SG-Initiations_By_Reporting_Member_.pdf).

<sup>13</sup> Ibid.

<sup>14</sup> Ibid.

## V. REKOMANDIMET PËR PLOTËSIME DHE NDRYSHIME TË PROJEKT-LIGJIT PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORT

Analiza e Projekt Ligjit për Masat Mbrojtëse në Import është bërë në duke e krahasuar dhe vlerësuar me Standardet Ligjore të Rregullores së BE-së dhe rregullativën ligjore të OBT-së.

Andaj, rekomandimet janë ndarë në dy grupe kryesore: a) Rekomandime strukturore mbi Projekt Ligjin për Masat Mbrojtëse për Import dhe b) Rekomandimet e Detajuara. Përmes rekomandimeve strukturore, jepen rekomandime të përgjithshme të cilat prekin substancën e një neni, kapitulli apo të një zgjidhje ligjore të rekomanduara me projektligj. Në anën tjetër, përmes rekomandimeve të detajuara, jepen rekomandime në lidhje me nene specifike dhe zgjidhje ligjore specifike.

### A. Projekt ligji duhet të ndryshojë përcaktimin e llojeve të masave mbrojtëse dhe duhet të definojë parimet të përgjithshme për aplikimin e masave mbrojtëse

Neni 4.1 i Projekt-ligjit për Masat Mbrojtëse në import nuk është në përputhje me Nenin 19 të të njëjtit projekt-ligj sa i përket definimit të llojeve të masave mbrojtëse në import të cilat lejohen të aplikohen në Kosovë. Të njëjtat Nene duhet të rishikohen dhe të ri-draftohen në mënyrë që të jenë në përputhje me standardet ligjore të OBT-së dhe Rregullores BE-së për Rregullat e Përbashkëta për Import dhe të shmangët konflikti juridik mes tyre.

Përmes nenit 4.1. të Projekt-ligjit për Masat Mbrojtëse në Import, si masë e lejuar mbrojtëse është “*detyrimi mbrojtës ad valorem i llogaritur sipas vlerës së produktit të importuar*”. Interpretimi juridik i këtij neni dërgon në përfundimin se masa e vetme e lejuar mbrojtëse është vendosja e detyrimeve shtesë doganore, duke mos njohur masa tjera mbrojtëse.

Në anën tjetër, përmes Nenit 19, paragrafi 3 i Projekt-Ligjit për Masa Mbrojtëse përcakton se “*masat mbrojtëse marrin formën e 3.1. Vlerës Doganore Shtesë, 3.2. Kufizimeve sasiore të produkteve*”. Interpretimi juridik i këtij Neni dërgon në përfundimin se janë dy forma të masave mbrojtëse, dhe atë vlera shtesë doganore, dhe kufizimet sasiore.

Përderisa këto dy nen janë në kundërshtim me njëra tjetrën, ato janë në mos-përputhje edhe me standardet ndërkombëtare udhëzuese. Neni 5.1 i Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse dhe Neni 15 i Rregullores së BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import parashohin se llojet e masave mbrojtëse nuk kufizohen, dhe se ato janë në diskrecion të shtetit varësisht nga nevoja dhe adresimi i dëmit të industrisë vendore të cilin e shkaktojnë. Në këtë mënyrë, përderisa vendosja e detyrimeve shtesë doganore dhe kufizimeve sasiore paraqesin mënyrën kryesore të adresimit, masat mbrojtëse nuk janë të kufizuara vetëm në këto dy masa.

Tutje, Ligji duhet të parashikojë edhe aplikimin e parimit të mos-diskriminimit në lidhje me aplikimin e Masave Mbrojtëse, kjo në përputhje me Nenin 2.2. Të Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse dhe Rregullores BE për Rregullat e Përbashkëta për Import.

<p>Nenet e Projekt - Ligjit të cilat duhet rishikuar dhe ridraftuar</p> <p>Neni 4.1. dhe Neni 19.3. Të ridraftohen</p>	<p>Standardi ligjor i OBT-së dhe Rregullores BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import në bazë të së cilës këto nene duhet rishikuar</p> <p>Neni 5.1 i Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse dhe Neni 15 i Rregullores së BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import</p>
<p>Definimi i rekomanduar:</p> <p><u>“Masat mbrojtëse marrin formën e:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. <u>Vlerës doganore shtesë</u></li> <li>b. <u>Kufizimeve sasiore të importeve</u></li> <li>c. <u>Forma tjera të masave mbrojtëse të përshtatshme për të parandaluar apo adresuar dëmin për industrinë vendore</u></li> </ol>	<p>Arsyetimi:</p> <p>Përderisa masat kryesore mbrojtëse në import janë dy (2), detyrimet shtesë doganore dhe kufizimet sasiore, <b>llojet e masave mbrojtëse nuk kufizohen dhe duhet të jenë në diskrecion të shtetit varësisht nga nevoja dhe situata.</b></p> <p>Në përputhje me Nenin 5.1. të Marrëveshjes për masa mbrojtëse, diskrecioni për zgjedhjen e mjeteve efektive është i shtetit, pa kufizime të formës.</p> <p><i>“Anëtarët do të zgjedhin masat më të përshtatshme për arritjen e këtyre objektivave (i.e. adresimi i çështjes së dëmit industrisë vendore)”</i></p> <p>Ngjashëm, edhe Neni 15 i Rregullores së BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import nuk parashikon kufizimeve sa i përket dy formave të masave mbrojtëse.</p>
<p>Rekomandim:</p> <p>Të shtohet si Nen i ri - Neni 20</p>	<p>Standardi ligjor i OBT-së dhe Rregullores BE-së për Rregulla të Përbashkëta për Import në bazë të së cilës këto nene duhet rishikuar</p> <p>Neni 2.2. i Marrëveshjes për Masa Mbrojtëse</p>

<p>Definimi i rekomanduar i Nenit të ri:</p> <p>Masat mbrojtëse duhet të aplikohen në raport me produktet pa marrë parasysh vendin e origjinës.</p>	<p>Arsyetimi:</p> <p>Aplikimi i masave mbrojtëse duhet të bëhet duke mos diskriminuar origjinën e produkteve. Ky parim ka rëndësi të shtuar në rastet e kufizimeve sasiore dhe vendosjen e kuotave për shtetet eksportuese.</p>
---	---

## **B. Projekt ligji duhet të qartësojë rolin dhe kompetencat e ministrisë, qeverisë dhe të komisionit për vendosjen e masave mbrojtëse**

Përmes Projekt-Ligjit për Masat Mbrojtëse në Import përcaktohet se në raport me procesin e fillimit të hetimeve, zhvillimit të procedurës hetimore, përfundimit të hetimeve, apo Vendimit për aplikimin e masave mbrojtëse, janë tri (3) institucione kompetente vendim-marrëse, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni, dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Tutje, me nenin 5 themelohet Komisioni për Vendosjen e Masave Mbrojtëse. Komisioni themelohet si organizëm ndër-institucional i cili ka në përbërje të tij nëntë (9) anëtar nga nëntë (9) institucione të ndryshme.

Projekt-ligji për Masat Mbrojtëse në Import krijon paqartësi të mëdha në raport me procedurën vendim-marrëse dhe organet vendim-marrje, dhe krijon standarde kontradiktore në vetvete. Nenet e aplikueshme në lidhje me procesin e fillimit të hetimeve, zhvillimit të procedurës hetimore, përfundimit të hetimeve, apo Vendimit për aplikimin e masave mbrojtëse, nuk përcaktojnë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë vendim-marrëse për secilën nga fazat për aplikimin e masave mbrojtëse.

Si shembull ilustrues, përmes Nenit 18.1 përcaktohet se Vendimi për Aplikimin e masave mbrojtëse merret nga Qeveria e Republikës së Kosovës pas rekomandimit të Komisionit, kështu duke e përjashtuar në tërësi Ministrinë nga procesi vendim-marrës dhe konsultativ. Në anën tjetër, me Nenin 19, Vendimin për masa mbrojtëse përfundimtare, parashihet se Vendimi për aplikim e masave përfundimtare merret nga Ministria, duke përjashtuar në tërësi nga procesi vendim-marrës Komisionin dhe Qeverinë.

Ngjashëm, përmes nenit 16.1 përcaktohet se në rast të përfundimit të hetimit për shkak të mungesës së provave, Vendimi merret nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, për aplikimin e masave përfundimtare, Qeveria përjashtohet në tërësi nga procedimivendim-marrës.

Zgjidhja e rekomanduar për këtë është ndryshimi i Nenit të 5, dhe shtimi i dy paragrafëve për të krijuar një strukturë unike vendim-marrëse. Në këtë drejtim, kërkohet pastaj të ri-formulohen nenet specifike të cilat parashohin dualizëm të kompetencave.

Të plotësohet Neni 5, duke shtuar paragrafët në vazhdim

5.5. Procedura për fillimin e një hetimi apo refuzimin e fillimit të një hetimit merret nga ana e Ministrisë, pas konsultimit paraprak me Komisionin. Komisioni është i detyruar të lëshojë rekomandim me shkrim për Ministrinë në raport me kërkesën fillimin e hetimeve dhe provave të paraqitura.

5.6. Vendimi përfundimtar për përfundimin e Hetimit sipas Nenit 16, aplikimin e masave të përkohshme mbrojtëse sipas Nenit 18, apo aplikimit të masave mbrojtëse përfundimtare sipas nenit 19, merret nga Qeveria, sipas rekomandimit të përbashkët me shkrim të Ministrisë dhe Komisionit.

**Në përputhje me Nenin e ridraftuar 5.5. Dhe 5.6. Të rishikohen dhe ndryshohen Nenet 8.7, 9.1, 10.1, 15.1, 16.1, 18.1, 19.1., 18.7, 20.2.**

### **C. Projekt-ligji duhet të ulë kërkesat për pranueshmërinë e kërkesave për iniciimin e hetimit**

Projekt-ligji për Masat Mbrojtëse në import parashikon kushte strikte dhe shumë të larta në lidhje me përmbajtjen e kërkesave për iniciimin e procedurës së hetimit, dhe të pranueshmërisë së kërkesës për iniciimin e hetimit. Përmes Nenit 7, paragrafi 2 dhe përmes Nenit 8, limitohet mundësia e industrisë vendore për të inicuar Kërkesa për fillimin e hetimeve.

Fillimisht, pranueshmëria e kërkesës sipas Nenit 7, paragrafi 2, varet nëse Kërkesa për fillimin e hetimeve është paraqitur nga prodhuesit vendor të cilët përbëjnë 50% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme, apo një prodhues vendor i cili prodhon jo më pak se 25% të prodhimit të përgjithshëm.

Së dyti, përmes nenit 8, parashihet që kërkesa duhet të përmbajë informacione të detajuara dhe tejet profesionale. Ndër të tjerë, nga parashtruesi i kërkesës kërkohet të dëshmojë: sasinë dhe vlerën e produktit vendor të produktit konkurrues, sasinë dhe vlerën e produkteve të importuara, informacione në lidhje me pozicionet konkurruese dhe kapacitetin vendor, informacione mbi ekzistimin e dëmit dhe të ngjashme. Të dy këto kërkesa janë përjashtuese, fillimisht në raport me pragun e lartë për paraqitjen e kërkesës dhe palët e autorizuar, dhe së dyti me kërkesat shumë të larta për përmbajtjen e kërkesës, për të cilat industria vendore mund të mos ketë kapacitete të mjaftueshme profesionale. Andaj, rekomandohet që fillimisht të zgjerohen palët e autorizuar për paraqitjen e Ankesës dhe të ulen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

Neni aktual	Ndryshimet e rekomanduara
<p>7.2. 2. Kërkesa me shkrim konsiderohet si e dorëzuar nga ose në emër të prodhuesve vendor vetëm nëse:</p> <p>2.1. përkrahet nga prodhuesit vendor të cilët së bashku përbëjnë mbi 50% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike;</p> <p>2.2. një prodhues vendor, i cili kërkon iniciimin e hetimeve, prodhon jo më pak se 25% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike.</p>	<p>2. Kërkesa me shkrim për iniciimin e Hetimevedorëzohet pranë Ministrisë nga ana e palëve të autorizuar, të cilat përfshijnë:</p> <p>2.1. prodhuesit vendor të cilët së bashku përbëjnë mbi 20% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike;</p> <p>2.2. një prodhues vendor, i cili kërkon iniciimin e hetimeve, prodhon jo më pak se 10% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike.</p> <p>2.3. Shoqatat tregtare, të biznesit, asociacionet ekonomike dhe të ngjashme, ku shumica e anëtarëve janë prodhues të produktit njëjtë ise drejtpërdrejtë konkurrues në Republikën e Kosovës, dhe kanë në përbërje të paktën 20 biznese prodhuese të industrisë vendore;</p> <p>2.4. Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, duke përfshirë por mos u kufizuar Doganat e Kosovës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Administrata Tatimore dhe të ngjashme.</p>
<p>Shtimi i nenit të ri pas Nenit 7.3.</p>	<p>Në rast kur kërkesa për Iniciimin e hetimeve nuk i plotëson kërkesat e pranueshmërisë sipas paragrafit 2.1., 2.2., dhe 2.3., por përmban fakte dhe prova bindëse për rritje të importeve në mënyrë të paparashikuar dhe shkaktimin e dëmit apo rrezikun e shkaktimit të dëmit për industrinë vendore, Ministria është e detyruar që të shqyrtojë informacionet e tilla dhe të iniciojë procedurën hetimore sipas detyrës zyrtare.</p>
<p>Shtimi i një paragrafi të ri, pas paragrafit 1.10 të Nenit 8</p>	<p>Kërkesa për iniciimin e hetimeve nuk mund të refuzohet në rast se ndonjë prej provave apo informacioneve të kërkuara në paragrafet më lartë përbën informacion jo-publik të institucioneve publike të Republikës së Kosovës, në rast se informacioni është vështirë i qasshëm, apo nëse prova dhe informacionet e kërkuara mund të sigurohen vetëm në një vend të tretë dhe kanë kosto të madhe ekonomike.</p>



---

“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.